



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1121/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesuese, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes- thyerje e heshtjes zgjedhore, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** e bazuar ankesa Anr.1121/2021, e datës 14.11.2021, e paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 1,200.000 (njëmijë e dyqind euro), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

**II. DETYROHET** Subjekti Politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë që gjobën e shqiptuar si në pikën **-I-** të dispozitivit të këtij vendimi ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

Me datë 14.11.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.1121/2021, e paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje në të cilin pretendon se me datë 13 nëntor 2021 rreth orës 23:00 të mbrëmjes kanë vërejtur se mbështetësi i LVV-së Tomë Gashi ka thyer heshtjen zgjedhore në rrjetin social facebook në shtatë raste dhe atë ka postuar foto me kryeministrin Albin Kurti duke bërë thirrje për votim

“Ne jemi gati me fitu 144 me zemër me mendje me votu”, ka postuar fotografi të kandidatit për kryetar komune te Prishtinës nga radhët e LVV-së Arben Vitia me mbishkrim dhe thirrje për votim “Mos i besoni atij që jua banë kryet Dubai. Votone Arben Vitina që naj ban Prishtinën tonë të jetueshme, me zemër me mendje Lëvizja Vetëvendosje”, ka postuar një fotografi- shtyllë elektrike me mbishkrim dhe thirrje për votim “Nëse nuk doni me ja pshtjell vetit punët sic i kane pshtjell këta për 21 vjet. Votoni 144 Votoni Arben Vitia”, ka postuar një fotografi të kandidates për kryetar komune të Gjakovës nga radhët e LVV-së – Mimoza Kusari Lila me mbishkrim për thirrje për votim, ka postuar një fotografi me mbishkrim dhe thirrje për votim për të gjithë kandidatët për kryetar komune të subjektit politik t Lëvizjes Vetëvendosje me mbishkrim dhe thirrje për votim “ Nëse doni me jetu ma mirë. Voto për ndryshime. Boll ju kanë rrejt e mashtru për 21 vjet. Jepni shancë vetes dhe fëmijëve tuaj. Me 144 me Lëvizjen Vetëvendosje” , ka postuar një foto me mbishkrim “ Ngone Ajshtajnin, mos i votoni negativat që na kanë lodh e na kan vjedh qe 21 vjet. Voto perspektivën për të gjithë ne. Voto 144. Voto Lëvizjen Vetëvendosje si dhe ka postuar një video të rock-grupit Troja me mbishkrim dhe thirrje për votim “ Ngone Trojën mos i votoni hajnat”. Ankesës i ka bashkangjitur foto si dëshmi.

PZAP, me datë 14.11.2021 i ka dërguar kërkesë për përgjigje Subjektit Polittik Lëvizja Vetëvendosje, duke i kërkuar që të përgjigjet deri me datë 14.11.2021 në ora 17:00.

Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje me datë 14.11.2021 ka paraqitur pranë PZAP-së përgjigje në ankesë në të cilën i ka kundërshtuar pretendimet si në ankesë duke theksuar se mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje Tomë Gashi të gjitha materialet e shpërndara në rrjetin social facebook të theksuara në ankesë tanimë nuk janë aktive dhe as të sponsorizuara pasi që i njëjti i ka larguar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli, pas shqyrtimi të shkresave të lëndës ka konstatuar se Subjekti Politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, përkatësisht mbështetësi si tyre Tomë Gashi gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin social “Facebook” kanë bërë fushatë zgjedhore ashtu që përmes rrjetit social “Facebook” kanë bërë shtatë postime me përmbajtje dhe thirrje për votim për

subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrës te Votimit për hedhjen e votës, e deri ne mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve te tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 14.11.2021 ndërmoi hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazura ngase në kohën kur është bërë ekzaminimi i postimeve të Tom Gashit të kontestuara në bazë të ankesës nga ana e personit zyrtar të PZAP-së është gjetur se postimet e kontestuara ishin publikuar me datë 13 nëntor 2021 në intervalin kohor prej orës 7:31 në mëngjes e deri në orën 21:46 dhe këto postime nuk shfaqeshin automatikisht mirëpo ishin postime të shënuara nga vetë përdoruesi i llogarisë së Facebook.

Në raport me pretendimet e Subjektit Politik Lëvizja Vetvendosje se materialet e shpërndara në rrjetin social nga Tomë Gashi tanimë nuk kanë aktive dhe as të sponsorizuara pasi që i njëjti i ka larguar, Paneli i vlerësoi si të pabazuara ngase me dispozita ligjore, subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohet të bëjnë fushatë, në një mënyrë apo tjetër 24 orë para hapjes së Qendrës te Votimit dhe se ka qenë ende aktiv postimi është vërtetuar pas verifikimeve të bëra nga PZAP, andaj si e tillë konsiderohet se është bërë shkelje e heshtjes zgjedhore prandaj edhe se ankesa e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës është e bazuar.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marrë parasysh rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë paneli mori faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba Lëvizja Vetëvendosje LVV, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe ka marrë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore dhe faktin se subjekti politik në fjalë ka bërë përpjekje që ti njoftoj kandidatët e saj lidhur me respektimin e legjislacionit në fuqi me qëllim të evitimit të shkeljeve gjatë heshtjes zgjedhore, e të cilat rrethana kanë ndikuar në lehtësimin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi, nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ *Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.*”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekura në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.1121/2021 më datë 15.11.2021

**Kryesues i Panelit**  
Adnan Konushovci



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***